


**GJENDJA E PËRGJITHSHME NË EDUKIM  
PARASHKOLLOR 0-6 VJEÇ, NË INSTITUCIONET  
PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOSOVË**

*Raport hulumtimi*

**Mevlude Aliu-Gashi**



Prishtinë, 2014



Mevlude Aliu-Gashi

**GJENDJA E PËRGJITHSHME NË EDUKIM  
PARASHKOLLOR 0-6 VJEÇ, NË INSTITUCIONET  
PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOSOVË**

*Raport hulumtimi*

Prishtinë, 2014

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Autore:**

Mevlude Aliu-Gashi

**Redaktor përgjegjës:**

Ismet Potera

**Lektor:**

Bekim Morina

**Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

# PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	5
Përkufizimi i termave kryesorë:.....	6
Lista e tabelave: .....	7
Lista e figurave: .....	8
Parathënie.....	9
1. Hyrje .....	10
2. Qëllimi .....	12
2.1. Objektivat e hulumtimit .....	12
3. METODOLOGJIA .....	13
3.1. Korniza konceptuale dhe teorike .....	13
3.2. Ecuria e hulumtimit.....	13
3.3. Metodot e hulumtimit.....	14
3.4. Mostra e përfshirë në hulumtim .....	14
3.5. Respondentët .....	15
3.6. Instrumentet.....	16
4. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT.....	16
4.1. Rezultatet dhe interpretimi .....	16
4.1.1. Gjendja në institucionet parashkollore publike, për moshën e fëmijëve 0-3 vjeç .....	16
4.1.2. Gjendja në institucionet parashkollore publike për moshën e fëmijëve 3-6 vjeç .....	22
4.1.3. Përgatitja profesionale e edukatoreve .....	28
4.1.4. Kërkesat për regjistrim dhe pranimi i fëmijëve në institucione parashkollore .....	31

4.1.5. Mundësia për themelimin e klasave shtesë në kuadër të objekteve ekzistuese.....	33
5. Përfundim.....	36
6. Rekomandime .....	37
3.1. Rekomandimet për MASHT-in.....	37
5.2. Rekomandimet për Komunat .....	38
5.3. Rekomandimet për institucionet parashkollore .....	38
5.4. Rekomandimet për Institutin Pedagogjik.....	39
7. Bibliografi .....	40
8. Shtojca.....	41
9. PYETËSOR PËR DREJTORË/DREJTORESHA TË INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE .....	41

## Shkurtesat

DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FNV	Fëmijët me Nevoja të Veçanta
IP	Institucione Parashkollore
HpH	Metodologjia Hap pas Hapi
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (2011-2016)
QBK	Qendra me Bazë në Komunitet
SZHMFH	Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme (0-6 vjeç)

Përkufizimi i termave kryesorë:

**Edukim parashkollor** - i referohet nivelit të edukimit të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç.

**Edukim parafillor** - i referohet nivelit të edukimit të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç, në të gjitha format e organizimit (në shkollë, në institucion parashkollor, në qendra me bazë në komunitet), që është përgatitje e fëmijës për klasë të parë.

**Grupe/klasë parashkollore** – klasë ku organizohet edukimi për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, në kuadër të institucioneve parashkollore.

**Institucione parashkollore publike** - kopshtet dhe çerdhet ku organizohet edukimi për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, me qëndrim tërëditor të fëmijëve.

**Qendra me bazë në komunitet** – QBK - objekte në të cilat organizohet edukimi parashkollor/parafillor, por që financohen nga komuniteti (prindërit, OJQ-të etj.), me qëndrim gjysmëditor.

**Edukator/e** - i/e punësuar me përgatitje profesionale për të realizuar edukimin parashkollor 3-6 vjeç.

**Motër-edukatore** - i/e punësuar me përgatitje profesionale për të realizuar edukimin parashkollor për moshat e fëmijëve 0-3 vjeç.



Lista e tabelave:

**Tabela 1.** Numri i grupeve të fëmijëve 0-3 vjeç, numri i fëmijëve 0-3 vjeç, të përfshirë në edukim parashkollor dhe numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në këtë nivel të edukimit;

**Tabela 2.** Numri i motër-edukatoreve që punojnë me fëmijët 0-3 vjeç, numri i motër-edukatoreve që punojnë me një grup të fëmijëve dhe motër-edukatoret ndihmëse që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta, në këtë nivel të edukimit;

**Tabela 3.** Përgatitja profesionale e motër-edukatoreve;

**Tabela 4.** Numri i grupeve të fëmijëve 3-6 vjeç, të përfshirë në edukimin parashkollor publik;

**Tabela 5.** Numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parashkollor nga mosha 3-6 vjeç;

**Tabela 6.** Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe numri i edukatoreve ndihmëse që punojnë me këta fëmijë;

**Tabela 7.** Numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parashkollor publik;

**Tabela 8.** Përgatitja profesionale e edukatoreve që punojnë me fëmijë të moshës 3-6 vjeç;

**Tabela 9.** Mundësitë e pranimit të fëmijëve në institucione parashkollore;

**Tabela 10.** Mundësitë e krijimit të hapësirave më të mëdha për përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukim parashkollor publik;

**Tabela 11.** Nevojat për bashkëpunëtorë profesionalë në institucione parashkollore publike.

Lista e figurave:

Fig. 1. Me cilat metodologji punojnë institucionet parashkollore publike në Kosovë;

Fig. 2. Kërkesat për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore;

Fig. 3. Mundësitë e institucioneve për të pranuar fëmijë në institucione parashkollore

.

## **Parathënie**

Fëmijëria e hershme paraqet fazën më të ndjeshme në zhvillimin psikik, fizik dhe emocional të tij. Duke parë rëndësinë që ka kjo fazë e zhvillimit të fëmijës, i hymë punës hulumtuese për ta pasqyruar në mënyrë më reale gjendjen në këtë hallkë edukimi.

Këto të dhëna, të përmbledhura në këtë raport hulumtimi, do të jenë një bazë e mirë për të vazhduar me hulumtimin e aspekteve më të veçanta të punës në institucionin parashkollor.

Krahas niveleve të tjera, edhe nivelit të edukimit parashkollor është duke iu kushtuar rëndësi e veçantë, siç është zhvillimi i përgjithshëm i tij, duke planifikuar përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukim parashkollor, e sidomos në edukim parafillor, dhe përfshirjen e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç - përgatitjen e fëmijëve për klasë të parë.

Në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të edukimit parashkollor, i rëndësisë së veçantë është ky hulumtim në terren, ku janë përfshirë drejtuesit e institucioneve parashkollore, për të mbledhur të dhënat për gjendjen e përgjithshme në edukimin parashkollor publik.

Në këtë hulumtim nuk janë përfshirë institucionet parashkollore private, sepse është duke u bërë licencimi i tyre dhe nuk kemi pasur mundësi t'i përfshijmë edhe këto institucione.

Duke përfshirë më shumë fëmijë në edukimin parashkollor dhe duke ngritur këtë nivel të edukimit, do të ndikohet në ngritjen e cilësisë në etapat e tjera të shkollimit. Fëmijët do të jenë të

përgatitur për klasë të parë dhe mësimdhënësit e klasës së parë do ta kenë më lehtë të punojnë me fëmijët që kanë përgatitje paraprake edukative-arsimore.

Investimet në edukimin parashkollor/parafillor do të jenë investime në të ardhmen e ndritur të shoqërisë.

Të dhënat, rezultatet nga hulumtimi, tregojnë se ka shumë nevojë për të ndihmuar dhe ndryshuar në edukimin parashkollor. Gjetja e nevojave dhe sfidave me të cilat përballlet ky nivel i edukimit në Kosovë ishte synimi qendror i këtij hulumtimi. Besojmë se këto të dhëna do ta ndihmojnë përmirësimin dhe avancimin e kësaj hallke të sistemit arsimor. Gjithashtu, rekomandimet e dhëna do të ndihmojnë edhe politikëbërësit për të marrë hapa dhe vendime konkrete në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të edukimit parashkollor.

## **1. Hyrje**

Edukimi parashkollor në Kosovë përfshin moshën e fëmijëve 0-6 vjeç. Ky nivel i edukimit realizohet në çerdhe, mosha 0-3 vjeç, kopshte 3-6 vjeç, dhe në shkolla mosha 5-6 vjeç. Edukimi realizohet në institucione parashkollore publike, private, publiko-private dhe qendra me bazë në komunitet QBK.

Edukimi parashkollor është hallka a parë e edukimit institucional, i cili është bërë pjesë e të gjitha politikave edukativo-arsimore. Për këtë, politikat arsimore kanë hartuar strategji, ligje, plane strategjike, Kornizën e Kurrikulës, Standardet e Përgjithshme të Edukimit Parashkollor 3-6 vjeç, Kurrikulën për Edukim Parashkollor 3-6 vjeç, Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, udhëzime administrative dhe

dokumente të tjera zyrtare, që ndikojnë në zhvillimin e edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, e ka hartuar Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 – PSAK, në të cilin rëndësi e madhe i është kushtuar ngritjes së cilësisë në edukimin parashkollor dhe përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor/parafillor. Krahas këtij plani, MASHT-i është duke i përmbushur mangësitë e së kaluarës, duke realizuar shumë nga ato që i ka planifikuar dhe duke e rregulluar Kornizën ligjore për edukimin parashkollor.

Lidhur me përfshirjen e fëmijëve në edukimin parafillor, moshë 5-6 vjeç, në institucione parashkollore publike, klasa parafillore dhe qendra me bazë në komunitet, është realizuar një hulumtim i veçantë, i cili është publikuar. Ndërsa, ky hulumtim është realizuar për gjendjen e përgjithshme në edukimin parashkollor, moshë 0-6 vjeç, në institucione parashkollore publike.

Për këtë nuk është bërë ndonjë hulumtim, përveç të dhënave statistikore që i publikon MASHT-i, çdo vit. Pra, nuk kemi të dhëna të tjera, përveç shifrave të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe numrin e stafit që punon në këtë nivel të edukimit.

Gjatë vitit 2013, është realizuar ky hulumtim, në të cilin janë përfshirë 36 institucione parashkollore publike. Janë mbledhur të dhëna për përfshirjen e fëmijëve të moshës 9 muaj deri në 6 vjet, në institucione parashkollore publike, nevojën për përfshirje më të madhe, përgatitjen profesionale të kuadrit edukativ që punojnë me fëmijë në këto institucione, përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione parashkollore, mundësitë që kanë institucionet për të zgjeruar objektet dhe për të mundësuar

përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukim parashkollor, nevojën për pedagogë/psikologë në institucione parashkollore etj. Rezultatet dhe rekomandimet e dala nga ky hulumtim do të shërbejnë për politikën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe për të gjithë ata që merren me këtë nivel të edukimit.

## **2. Qëllimi**

Hulumtimi ka për qëllim pasqyrimin i gjendjes reale në edukimin parashkollor publik në Kosovë, si dhe dhënien e kaheve për përmirësimin dhe avancimin e kësaj gjendjeje.

### **2.1. Objektivat e hulumtimit**

- Të identifikohet gjendja e përgjithshme në edukimin parashkollor: shkalla e përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor publik, përgatitja profesionale e motër-educatoreve dhe edukatoreve, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në edukim parashkollor, nevojat dhe mundësitë për përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor dhe nevoja për bashkëpunëtorë profesionalë në institucione parashkollore;
- Të përpunohen të dhënat dhe të analizohen rezultatet e hulumtimit;
- Adresimi i rekomandimeve për politikën dhe vendimmarrësit që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor 0-6 vjeç;

- Përgatitja dhe botimi i raportit për prezantimin e rezultateve e këtij hulumtimi.

### **3. METODOLOGJIA**

Hulumtimi është kuantitativ dhe vlerësues.

#### **3.1. Korniza konceptuale dhe teorike**

Edukimi parafillor dhe edukimi parashkollor, në përgjithësi në Kosovë, kanë përfshirje jo të kënaqshme. MASHT-i është duke i kushtuar më shumë rëndësi këtij niveli të edukimit, për arsye se kjo e kushtëzon ngritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimit edhe në nivele më të larta. Edukimi parashkollor rregullohet me Kornizën Ligjore të Arsimit Parauniversitar, me Ligjin për Arsimin në Komuna me Ligjin për Edukimin Parashkollor, me Standardet e Përgjithshme të Edukimit Parashkollor 3-6 vjeç dhe me Udhëzimet Administrative që i plotësojnë ligjet në fuqi.

Të gjithë faktorët që ndikojnë në edukimin parashkollor janë duke bërë përpjekje që kjo kornizë ligjore të zbatohet dhe të arrihen synimet e parapara për cilësinë në arsim. Ky hulumtim është një mbështetje që u jepet faktorëve relevantë, që procesi të shkojë përpara.

#### **3.2. Ecuria e hulumtimit**

Bazuar në nevojat për statistikat në edukimin parashkollor, për përfshirjen dhe mospërfshirjen e fëmijëve në edukim parashkollor, si dhe të dhëna të tjera lidhur me edukimin parashkollor, Instituti Pedagogjik i Kosovës e ka realizuar këtë

hulumtim, duke përfshirë 22 komuna - 36 institucione parashkollore.

U hartua plani i veprimit në detaje për grumbullimin e të dhënave, kalendarin e realizimit, përbërjen e ekipit etj. Është hartuar instrumenti për hulumtim, për drejtues të institucioneve parashkollore.

Në të gjitha institucionet parashkollore janë kontaktuar me telefon drejtuesit e IP-ve, u janë dërguar pyetësorët në mënyrë elektronike për përgatitjen e të dhënave, pastaj ekipi ka shkuar në secilin IP për të realizuar grumbullimin e të dhënave. Përpunimi i tyre është bërë me teknikat e përpunimit statistikor, është bërë analiza/krahasimi i të dhënave dhe është përgatitur raporti.

### **3.3. Metodat e hulumtimit**

Për realizimin e hulumtimit janë zbatuar këto metoda:

**Metoda e analizës teorike** - Janë analizuar dokumentet: Ligjet, Udhëzimet Administrative, Standardet, Kurrikulat, Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës – PSAK etj.

**Metoda statistikore** - Për përpunimin e të dhënave nga terreni është përdorur programi Excel, ndërsa raporti është përgatitur në programin Word.


### **3.4. Mostra e përfshirë në hulumtim**

Janë gjithsej 34 institucione parashkollore publike dhe 2 institucione parashkollore publiko-private në 22 komuna të Kosovës, të cilat kanë ofruar informacione për gjendjen e



edukimit parashkollor. Komunat e përfshira në hulumtim paraqiten në figurën e mëposhtme:

### Harta me vendet e përfshira



### 3.5. Respondentët

Në mostër për hulumtim janë përfshirë 36 drejtorë/drejtoresha të institucioneve parashkollore, që e kanë plotësuar pyetësin përkatës, në 22 komuna të Kosovës.

### **3.6 Instrumentet**

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hulumtim, u përgatit pyetëtori, i cili u plotësua nga drejtorët/drejtoreshat e të gjitha institucioneve parashkollore publike dhe dy institucione parashkollore publiko-private.

## **4. MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT**

Shfrytëzimi i literaturës lidhur me hulumtimin, grumbullimi i të dhënave nga zyra e statistikave në MASHT (për numrin e grupeve të fëmijëve nëpër grupmosha, për numrin e fëmijëve, etj.), hartimi i projektit hulumtues, hartimi i pyetëtorit, realizimi i pyetëtorit në terren, analiza e të dhënave, prezantimi i rezultateve dhe rekomandimeve, adresimi i tyre në institucionet përkatëse.

### **4.1. Rezultatet dhe interpretimi**

Rezultatet e hulumtimit janë të paraqitura në formë të tabelave dhe figurave, duke u bërë interpretimi i përgjigjeve të secilës pyetje, si dhe analiza dhe krahasimi i rezultateve.

Gjetjet janë të paraqitura dhe të sistemuara duke u bazuar në pyetjet hulumtuese dhe janë të ndërlidhura ndërmjet vete, duke paraqitur një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes në këtë nivel të edukimit.

4.1.1. Gjendja në institucionet parashkollore publike, për moshën e fëmijëve 0-3 vjeç

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur 22 komunat e përfshira në

hulumtim, të dhënat për fëmijët e moshës 0-3 vjeç, në 36 institucione parashkollore. Pra, janë gjithsej 105 grupe me fëmijë 0-3 vjeç dhe gjithsej 1549 fëmijë 0-3 vjeç të përfshirë në këto institucione. Nëpër këto grupe janë të përfshirë gjithsej 21 fëmijë me nevoja të veçanta.

**Tabela 1.** Numri i grupeve të fëmijëve 0-3 vjeç, numri i fëmijëve 0-3 vjeç të përfshirë në edukim parashkollor dhe numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në këtë nivel të edukimit.

	Komuna	Institucione parashkollore	Grupe të fëmijëve 0-3 vjeç	Fëmijë të moshës 0-3 vjeç	FNV, të moshës 0-3 vjeç, të përfshirë në edukim parashkollor
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	8	116	2
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”	3	45	1
3	Prishtinë	“Fatosat”	6	95	2
4	Prishtinë	“Yllkat” –PR	5	80	1
5	Prishtinë	“Dielli”	5	89	0
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”	3	40	0
7	Prishtinë	“Ardhmëria”	3	48	0
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	0	0	0
9	Podujevë	“Drita”	2	30	0
10	Drenas	“Ardhmëria”	3	27	2
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	4	66	1
12	Obiliq	“Rrita jonë”	1	24	0
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	6	126	1
14	Skenderaj	“Drita”	2	32	0
15	Vushtrri	“Foleja”	4	65	1
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	8	105	0

17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	1	11	0
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	1	4	0
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	2	27	0
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”	1	15	0
21	Istog- Vrellë	“Lulet e jetës”	1	10	0
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	1	19	0
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	1	5	0
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	9	106	2
25	Rahovec	“Tulipanët”	2	16	0
26	Prizren	“Yllka”	3	54	0
27	Suharekë	“Fluturat”	1	15	0
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	7	100	3
29	Lipjan	“QEAP”	2	30	0
30	Shtime	“Albiona Asllani”	1	11	2
31	Kaçanik	“Agimi”	1	10	0
32	Gjilan	“Integj”	3	45	0
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	1	16	0
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	1	16	1
35	Kamenicë	“Filizat”	1	9	0
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	2	42	2
Gjithsej			105	1549	21
			1570		

Në tabelën e dytë paraqitet numri i motër-edukatoreve që punojnë me këtë nivel të edukimit, pra janë 223 motër-edukatore. Është vetëm një institucion që ka një motër-edukatore ndihmëse për fëmijët me nevoja të veçanta, ndërsa në institucionet e tjera nuk ka motër-edukatore ndihmëse për këta fëmijë. Në 22 institucione parashkollore punojnë nga dy motër-edukatore me një grup të fëmijëve. Në 7 institucione parashkollore punon një motër-edukatore me një grup të fëmijëve. Ndërsa, në tri institucione të

tjera ka numër të ndryshëm të motër-educatoreve në një grup të fëmijëve (diku një, diku dy dhe diku tri edukatore në një grup, por ky numër ndryshon).

Dy institucione parashkollore nuk kanë fare grupe të fëmijëve të moshës 0-3 vjeç, pra në institucionet e tyre pranohen vetëm fëmijët nga mosha 3-6 vjeç.

Tabela 2. Numri i motër-educatoreve që punojnë me fëmijët 0-3 vjeç, numri i motër-educatoreve që punojnë me një grup të fëmijëve dhe motër-educatorët ndihmëse që punojnë me fëmijë me nevojë të veçanta, në këtë nivel të edukimit.

	Komuna	Institucione parashkollore	Motër-educatore që punojnë me fëmijë 0-3 vjeç	Motër-educatore që punojnë me një grup	Motër-educatore ndihmëse
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	18	2	0
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”	8	2	0
3	Prishtinë	“Fatosat”	12	2	0
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”	11	2	0
5	Prishtinë	“Dielli”	11	2	0
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”	6	2	0
7	Prishtinë	“Ardhmëria”	6	2	0
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	0	0	0
9	Podujevë	“Drita”	4	2	0
10	Drenas	“Ardhmëria”	5	2	0
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	8	2	0
12	Obiliq	“Rrita jonë”	3	3	0
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	15	2 dhe 3	1

14	Skenderaj	“Drita”	5	2 dhe 3	0
15	Vushtrri	“Foleja”	3	2	0
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	19	2	0
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	1	1	0
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	0	0	0
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	4	2	0
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”	1	1	0
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	1	1	0
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	2	2	0
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	1	1	0
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	28	1 dhe 2	0
25	Rahovec	“Tulipanët”	2	2	0
26	Prizren	“Yllka”	9	3	0
27	Suharekë	“Fluturat”	3	2	0
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	14	2	0
29	Lipjan	“QEAP”	4	2	0
30	Shtime	“Albiona Asllani”	1	1	0
31	Kaçanik	“Agimi”	2	2	0
32	Gjilan	“Integj”	4	1	0
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	3	2	0
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	2	2	0
35	Kamenicë	“Filizat”	3	3	0
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	4	2	0
Gjithsej			223		1

Në tabelën e tretë paraqitet përgatitja profesionale e motër-educatoreve. Pra, në institucione parashkollore janë 16 motër-educatore që e kanë të mbaruar shkollimin superior dhe janë 207 motër-educatore me shkollë të mesme.

Tabela 3. Përgatitja profesionale e motër-edukatoreve

	Komuna	Institucionet parashkollore	Përgatitja profesionale e motër-edukatoreve	
			Fakultet	Shkollë të mesme
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	1	17
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”		8
3	Prishtinë	“Fatosat”		12
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”		11
5	Prishtinë	“Dielli”		11
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”		6
7	Prishtinë	“Ardhmëria”		6
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”		0
9	Podujevë	“Drita”		4
10	Drenas	“Ardhmëria”	1	4
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	2	6
12	Obiliq	“Rrita jonë”		3
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”		15
14	Skenderaj	“Drita”		5
15	Vushtrri	“Foleja”		3
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”		19
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	1	0
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”		0
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	1	3
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”		1
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”		1
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	1	1
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”		1
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”		28
25	Rahovec	“Tulipanët”		2
26	Prizren	“Yllka”		9

27	Suharekë	“Fluturat”		3
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”		14
29	Lipjan	“QEAP”	2	2
30	Shtime	“Albiona Asllani”		1
31	Kaçanik	“Agimi”	1	1
32	Gjilan	“Integj”	3	1
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	1	2
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”		2
35	Kamenicë	“Filizat”	1	2
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	1	3
	Gjithsej		16	207

Deri më tani është paraqitur gjendja në institucionet parashkollore për moshën e fëmijëve 0-3 vjeç, ndërsa më poshtë do të paraqitet gjendja në institucionet parashkollore për moshën 3-6 vjeç.

#### 4.1.2. Gjendja në institucionet parashkollore publike për moshën e fëmijëve 3-6 vjeç

Në këtë tabelë është paraqitur numri i grupeve të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, në institucione parashkollore. Pra, janë 42 grupe me fëmijë të moshës 3-4 vjeç, 40 grupe të fëmijëve 4-5 vjeç dhe 51 grupe të fëmijëve 5-6 vjeç, si dhe 22 grupe mikse (mosha të kombinuara).



Tabela 4. Numri i grupeve të fëmijëve 3-6 vjeç, të përfshirë në edukimin parashkollor publik.

	Komuna	Institucioni parashkollor	Grupe të fëmijëve 3-4 vjeç	Grupe të fëmijëve 4-5 vjeç	Grupe të fëmijëve 5-6 vjeç.	Grupe mikse (të kombinuara) 3-6 vjeç
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	4	4	4	1
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”	1	1	1	1
3	Prishtinë	“Fatosat”	3	2	2	0
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”	2	2	2	2
5	Prishtinë	“Dielli”	2	2	2	0
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”	1	2	2	0
7	Prishtinë	“Ardhmëria”	1	1	2	1
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	2	2	1	0
9	Podujevë	“Drita”	1	1	0	0
10	Drenas	“Ardhmëria”	1	1	3	0
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	1	1	2	0
12	Obiliq	“Rrita jonë”	1	1	0	0
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	2	2	2	0
14	Skenderaj	“Drita”	1	1	1	0
15	Vushtrri	“Foleja”	1	1	2	0
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	3	3	7	1
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	0	0	0	1
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	0	0	0	1
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	1	1	1	0
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”	1	0	1	0
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	1	0	0	1
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	1	1	0	0

23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	0	0	1	1
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	2	4	2	3
25	Rahovec	“Tulipanët”	0	0	0	1
26	Prizren	“Yllka”	2	1	1	1
27	Suharekë	“Fluturat”	1	1	1	0
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	2	1	2	0
29	Lipjan	“QEAP”	1	1	0	0
30	Shtime	“Albiona Asllani”	0	0	0	1
31	Kaçanik	“Agimi”	0	0	5	2
32	Gjilan	“Integj”	1	1	1	0
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	1	1	1	1
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	1	1	1	0
35	Kamenicë	“Filizat”	0	0	0	2
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	0	0	1	1
			42	40	51	22

Në tabelën e pestë është paraqitur numri i fëmijëve nëpër grupe. Numri i fëmijëve të moshës 3-4 vjeç është 1002 fëmijë, numri i fëmijëve të moshës 4-5 vjeç është 922, numri i fëmijëve të moshës 5-6 vjeç është 1691 dhe numri i fëmijëve në grupet mikse (të kombinuara) është 464 fëmijë. Gjithsej janë 3077 fëmijë të moshës 3-6 vjeç të përfshirë në institucione parashkollore publike. Janë gjithsej 283 edukatore që punojnë me këta fëmijë.

Tabela 5. Numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parashkollor nga mosha 3-6 vjeç.

	Komuna	Institucione parashkollore	Fëmijë 3-4 vjeç	Fëmijë 4-5 vjeç	Fëmijë 5-6 vjeç	Fëmijë në grupe të kombinuara	Edukatore 3-6
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	94	93	99	18	36
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”	23	23	26	23	2
3	Prishtinë	“Fatosat”	80	57	50	0	14
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”	46	47	56	38	15
5	Prishtinë	“Dielli”	54	46	49	0	12
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”	26	48	43	0	10
7	Prishtinë	“Ardhmëria”	29	30	50	15	9
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	50	52	26	0	10
9	Podujevë	“Drita”	20	20	0	0	4
10	Drenas	“Ardhmëria”	16	22	72	0	7
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	36	33	46	0	12
12	Obiliq	“Rrita jonë”	27	29	0	0	5
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	74	69	65	0	12
14	Skenderaj	“Drita”	16	16	16	0	3
15	Vushtrri	“Foleja”	23	25	42	0	8
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	47	60	179	18	25
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	0	0	0	15	1
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	0	0	0	12	1
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	21	24	24	0	3
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”	20	0	22	0	3
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	16	0	0	21	2
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	18	19	0	0	2
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	0	0	6	23	2

24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	38	45	380	87	20	
25	Rahovec	“Tulipanët”	0	0	0	24	1	
26	Prizren	“Yllka”	57	20	21	19	11	
27	Suharekë	“Fluturat”	12	15	27	0	2	
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	59	33	63	0	10	
29	Lipjan	“QEAP”	28	25	0	0	4	
30	Shtime	“Albiona Asllani”	0	0	0	11	1	
31	Kaçanik	“Agimi”	0	0	224	53	8	
32	Gjilan	“Integj”	22	24	28	0	8	
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	25	27	28	25	7	
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	25	20	25	0	6	
35	Kamenicë	“Filizat”	0	0	0	39	3	
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	0	0	24	23	4	
			1002	922	1691	464	<b>283</b>	
			Gjithsej <b>3077</b> fëmijë 3-6 vjeç					

Tabela e mëposhtme paraqet përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në edukimin 3-6 vjeç. Pra, janë gjithsej 86 fëmijë me nevoja të veçanta që janë të përfshirë në edukim 3-6 vjeç dhe 14 asistente (edukatore ndihmëse), që punojnë me këta fëmijë.

Tabela 6. Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe numri i edukatoreve ndihmëse që punojnë me këta fëmijë.

	Komuna	Institucioni parashkollor	FNV 3-6 vjeç	Edukatore për FNV
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	13	1
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”	0	0
3	Prishtinë	“Fatosat”	1	0
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”	2	0
5	Prishtinë	“Dielli”	2	0
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”	3	1

7	Prishtinë	“Ardhmëria”	5	1
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	7	Asistente personale
9	Podujevë	“Drita”	0	0
10	Drenas	“Ardhmëria”	0	0
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	0	0
12	Obiliq	“Rrita jonë”	1	0
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	7	1
14	Skenderaj	“Drita”	1	0
15	Vushtrri	“Foleja”	2	1
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	9	1
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	0	0
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	1	0
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	0	0
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë”	0	0
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	0	0
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	0	0
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	2	1
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	6	1
25	Rahovec	“Tulipanët”	0	0
26	Prizren	“Yllka”	1	0
27	Suharekë	“Fluturat”	1	0
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	2	1
29	Lipjan	“QEAP”	0	0
30	Shtime	“Albiona Asllani”	2	0
31	Kaçanik	“Agimi”	0	0
32	Gjilan	“Integj”	5	2
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	3	1
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	9	2
35	Kamenicë	“Filizat”	0	0
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	1	0
			86	14

Tabela 7. Numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parashkollor publik.

	Fëmijë të përfshirë në edukimin parashkollor 0-3 vjeç.	Fëmijë të përfshirë në edukimin parashkollor 3-6 vjeç.	Gjithsej fëmijë të përfshirë në IP publike në Kosovë.
Nr.	1570	3163	4733

Këto shifra paraqesin përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor publik, por nuk përfshihet edukimi parashkollor privat dhe qendrat me bazë në komunitet - QBK, ngase përfshirja e tyre në këto shifra do të rriste numrin e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor.

#### 4.1.3. Përgatitja profesionale e edukatoreve

Një ndër prioritetet e të gjitha institucioneve që merren me edukim dhe arsim në Kosovë është cilësia në arsim. Për të arritur këtë, i është dhënë rëndësi e madhe ngritjes dhe përgatitjes profesionale të drejtorëve/eve për udhëheqje arsimore dhe të ngritjes profesionale të edukatoreve. Prandaj, përgatitja profesionale dhe zhvillimi profesional i edukatoreve dhe motër-edukatoreve është i domosdoshëm për ngritjen e cilësisë në nivelin e edukimit parashkollor.

Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar të dhënat për përgatitjen profesionale të edukatoreve që punojnë me fëmijët parashkollor 0-6 vjeç, e që është kështu: 56 edukatore e kanë të përfunduar Fakultetin e edukimit, drejtimi parashkollor, 4 edukatore e kanë Fakultetin e edukimit drejtimi fillor; janë 30 edukatore me Fakultet të pedagogjisë; 166 edukatore me shkollë të lartë pedagogjike dhe 25 edukatore kanë përgatitje tjetër (nga ato që u

cekën më lart).

Tabela 8 paraqet përgatitjen profesionale të edukatoreve që punojnë me fëmijë të moshës 3-6 vjeç.

	Komuna	Institucionet parashkollore	Përgatitja profesionale e edukatoreve				
			Parashkollor	Fillor	Pedagogji	SHLP	Tjetër
1	Prishtinë	"Gëzimi Ynë"	10	0	7	10	1
2	Prishtinë	"Xixëllonjat"	3	0	0	4	0
3	Prishtinë	"Fatosat"	3	0	5	6	0
4	Prishtinë	"Yllkat-PR"	0	0	2	13	0
5	Prishtinë	"Dielli"	1	0	1	10	0
6	Prishtinë	"Buzëqeshja"	1	0	1	8	0
7	Prishtinë	"Ardhmëria"	2	0	1	5	1
8	Prishtinë	"SOS Kopshti"	1	0	2	2	5
9	Podujevë	"Drita"	1	0	1	2	0
10	Drenas	"Ardhmëria"	5	0	0	2	0
11	F. Kosovë	"Gëzimi Ynë"	0	0	0	1	11
12	Obiliq	"Rrita jonë"	2	0	1	2	0
13	Mitrovicë	"Gëzimi Ynë"	1	0	1	10	0
14	Skenderaj	"Drita"	0	0	0	2	1
15	Vushtrri	"Foleja"	1	0	1	6	0
16	Pejë	"Pëllumbat e paqes"	4	0	4	17	0
17	Istog	"Ardhmëria Jonë"	0	0	1	0	0
18	Istog	"Pëllumbat e ardhmërisë"	0	0	0	0	1
19	Istog	"Gëzimi Ynë"	0	0	0	3	0
20	Istog-Banjë	"Shpresa Jonë"	1	0	1	0	1


21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	2	0	0	0	0
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	0	0	0	0	2
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	0	1	0	0	1
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	0	0	0	20	0
25	Rahovec	“Tulipanët”	0	0	0	1	0
26	Prizren	“Yllka”	0	2	0	8	1
27	Suharekë	“Fluturat”	0	0	0	2	0
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	8	0	0	2	0
29	Lipjan	“QEAP”	0	0	0	4	0
30	Shtime	“Albiona Asllani”	0	0	0	1	0
31	Kaçanik	“Agimi”	2	0	0	6	0
32	Gjilan	“Integj”	1	0	1	6	0
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	5	0	0	3	0
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	1	0	0	5	0
35	Kamenicë	“Filizat”	0	0	0	3	0
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	1	1	0	2	0
Gjithsej			56	4	30	166	25

Sa i përket pyetjes se me cilat metodologji të punës edukative punojnë institucionet parashkollore, kemi këto përgjigje: 14 institucione parashkollore punojnë me metodologjinë HAP PAS HAPI; 11 institucione me metodologjitë HAP PAS HAPI dhe MAJEUTIKA; 7 institucione me metodologjitë TRADICIONALE dhe HAP PAS HAPI; 3 institucione me metodologjitë REGJIO EMILIA dhe HAP PAS HAPI dhe vetëm 1 institucion me metodologjinë MAJEUTIKA. Këtë e paraqesim në figurën më poshtë:

HpH	HpH dhe Majeutika	HpH dhe Tradicionale	HpH dhe Regjio Emilia	Majeutika
14	11	7	3	1



Fig. 1. Me cilat metodologji punojnë institucionet parashkollore publike në Kosovë



Përveç të dhënave statistikore, që kanë të bëjnë me përfshirjen e fëmijëve parashkollorë në edukim, përgatitja profesionale e edukatoreve dhe metodologjitë, me të cilat punohet në këto institucione që paraqiten në këtë raport, janë edhe disa të dhëna që do të paraqesin gjendjen për mundësinë e pranimit të më shumë fëmijëve në institucion, kërkesat e prindërve për regjistrim të fëmijëve në raport me mundësitë e pranimit nga ana e institucionit parashkollor, nevojat për pedagogë etj.

#### 4.1.4. Kërkesat për regjistrim dhe pranimi i fëmijëve në institucione parashkollore

Kërkesat për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore janë shumë të madha, në krahasim me mundësitë e pranimit të

tyre në. Prandaj, si pjesë e këtij hulumtimi ishin edhe të dhënat për kërkesat e prindërve për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore dhe mundësitë për t'u pranuar. Në pyetësor u është dhënë mundësia të tregojnë drejtuesit e institucioneve parashkollore se sa aplikacione i kanë plotësuar prindërit dhe sa fëmijë janë pranuar në institucione. 4301 aplikacione janë bërë nga prindërit për pranimin e fëmijëve të tyre në institucione parashkollore, por janë pranuar vetëm 2888, ndërsa 1413 nuk janë pranuar.

Fig. 2. Kërkesat për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore





Fig. 3. Mundësitë e institucioneve për të pranuar fëmijë në institucione parashkollore.



Sic shihet në këtë paraqitje, 34 institucione e kanë pasur mundësinë të përfshijnë pjesërisht aplikacionet e plotësuara nga prindërit dhe vetëm dy institucione e kanë pasur mundësinë të përfshijnë plotësisht aplikacionet e plotësuara nga prindërit.

Tabela 9. Mundësitë e pranimit të fëmijëve në institucione parashkollore.

Mundësitë për pranim/regjistrim të fëmijëve në institucion	Numri i institucioneve
Pjesërisht	34 institucione
Plotësisht	2 institucione

#### 4.1.5. Mundësia për themelimin e klasave shtesë në kuadër të objekteve ekzistuese.

Në pyetjen a ka hapësirë në institucion për klasë shtesë,

respondentët i kanë dhënë këto përgjigje:

24 institucione nuk kanë hapësirë për klasë shtesë; 5 institucione kanë hapësirë, por nuk kanë kërkesa më të mëdha sesa ato që janë aktualisht; 6 institucione kanë hapësirë, por nuk kanë buxhet për të ndërtuar ose rregulluar klasë shtesë.

Tabela 10. Mundësitë e krijimit të hapësirave më të mëdha për përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor publik.

Klasë shtesë	Nuk ka hapësirë	Ka hapësirë, nuk ka kërkesa	Ka hapësirë, nuk ka buxhet	Nuk kanë dhënë përgjigje
	24 institucione	5 institucione	6 institucione	1 institucion
<b>Gjithsej 36 institucione parashkollore</b>				

### **A ka pedagog/psikolog në institucionin parashkollor dhe a është i nevojshëm pedagog/psikologu?**

Tabela më poshtë paraqet përgjigjet e dy pyetjeve më lart. Është vetëm një pedagoge për të gjitha institucionet parashkollore publike të Prishtinës dhe nuk ka në asnjë institucion parashkollor të komunave të tjera. Ndërsa, në pyetjen a është i nevojshëm i kanë dhënë këto përgjigje: 32 kanë thënë se janë shumë të nevojshëm pedagogu dhe psikologu në institucione dhe vetëm 4 kanë thënë se është pak i nevojshëm ky kuadër profesional.

Tabela 11. Nevojat për bashkëpunëtorë profesionalë në institucionet parashkollore publike.

	Komuna	Institucione parashkollore	A ka pedagog/psikolog	A është i nevojshëm pedagogu/psikologu në IP
1	Prishtinë	“Gëzimi Ynë”	1 pedagoge për të gjitha IP në Prishtinë	Shumë
2	Prishtinë	“Xixëllonjat”		Shumë
3	Prishtinë	“Fatosat”		Shumë
4	Prishtinë	“Yllkat-PR”		Shumë
5	Prishtinë	“Dielli”		Shumë
6	Prishtinë	“Buzëqeshja”		Shumë
7	Prishtinë	“Ardhmëria”		Shumë
8	Prishtinë	“SOS Kopshti”	po	Shumë
9	Podujevë	“Drita”	jo	pak
10	Drenas	“Ardhmëria”	jo	shumë
11	F. Kosovë	“Gëzimi Ynë”	jo	Shumë
12	Obiliq	“Rrita jonë”	jo	Shumë
13	Mitrovicë	“Gëzimi Ynë”	po	Shumë
14	Skenderaj	“Drita”	jo	Shumë
15	Vushtrri	“Foleja”	jo	Shumë
16	Pejë	“Pëllumbat e paqes”	jo	Shumë
17	Istog	“Ardhmëria Jonë”	jo	Shumë
18	Istog	“Pëllumbat e ardhmërisë”	jo	Shumë
19	Istog	“Gëzimi Ynë”	jo	Shumë
20	Istog-Banjë	“Shpresa Jonë	po	Shumë
21	Istog-Vrellë	“Lulet e jetës”	jo	Shumë
22	Klinë	“Xhevë Lladrovci”	jo	pak
23	Klinë-Shtupel	“Margarita kids”	po	pak
24	Gjakovë	“Ganimete Terbeshi”	Psikolog	Shumë
25	Rahovec	“Tulipanët”	jo	Shumë
26	Prizren	“Yllka”	jo	Shumë
27	Suharekë	“Flutura”	jo	pak
28	Ferizaj	“Ardhmëria Jonë”	jo	Shumë
29	Lipjan	“QEAP”	jo	Shumë

30	Shtime	“Albiona Asllani”	jo	Shumë
31	Kaçanik	“Agimi”	jo	Shumë
32	Gjilan	“Integj”	jo	Shumë
33	Gjilan	“Ardhmëria 2”	jo	Shumë
34	Gjilan	“Ardhmëria 1”	jo	Shumë
35	Kamenicë	“Filizat”	jo	Shumë
36	Viti	“Gëzimi Ynë”	jo	Shumë

## 5. Përfundim

Gjetjet nga hulumtimi rezultojnë se përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor publik në Kosovë është e ulët. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky nivel i edukimit për fazat e tjera të edukimit/arsimit, duhet t’i kushtohet më shumë rëndësi përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel të edukimit. Pas licencimit të numrit më të madh të institucioneve parashkollore private, do të mblidhen të dhëna dhe do të rritet përqindja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor në Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit paraqesin përfshirje të ulët të fëmijëve me nevoja të veçanta në edukimin parashkollor publik dhe po ashtu është i ulët edhe numri i motër-edukatoreve dhe edukatoreve ndihmëse për punë me fëmijë me nevoja të veçanta.

Përgatitja profesionale e motër-edukatoreve që punojnë me moshat 0-3 vjeç, në të shumtën e rasteve, ishte shkolla e mesme, e po ashtu edhe përgatitja profesionale e edukatoreve që punojnë me moshat 3-6 vjeç është e drejtimeve të ndryshme. Këto rezultate mund t’u shërbejnë faktorëve lokalë dhe qendrorë që kanë ndikim në edukimin parashkollor, për zhvillimin profesional të këtij kuadri, që në të ardhmen të mbështetet zhvillimi profesional adekuat i tyre, krahas punës që e bëjnë.

Kërkesat për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore, në shumë raste, ishte i madh, në krahasim me mundësitë e institucionit parashkollor, për të përfshirë më shumë fëmijë.

Sa i përket mundësisë për zgjerimin e hapësirave edukative në institucionet parashkollore, për përfshirje më të madhe të fëmijëve në këtë nivel të edukimit, rezultatet tregojnë se nëse niveli lokal i kushton më shumë rëndësi edukimit parashkollor publik, atëherë në të shumtën e rasteve mund të përmirësohet gjendja, duke pranuar edukatore sipas nevojës së institucionit, duke zgjeruar hapësirat edukative për të përfshirë më shumë grupe të fëmijëve etj.

Është theksuar nevoja për bashkëpunëtorë profesionalë në secilin institucion të përfshirë në hulumtim dhe në të shumtën e rasteve është paraqitur nevoja që institucionet parashkollore të kenë pedagog dhe psikolog në këto institucione.

## **6. Rekomandime**

### **3.1. Rekomandimet për MASHT-in**

- Të ndërmarrë të gjitha masat që niveli i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor të rritet dhe të realizohet ajo që është paraparë në Planin Strategjik të Arsimit 2011-2016 – PSAK, që deri në vitin 2015/2016 të përfshihen 70 % të fëmijëve në edukimin parashkollor;
- Edukatorët/et të kenë përgatitje adekuate për fëmijë të moshës parashkollore;

- Të ketë më shumë motër-educatore dhe edukatore mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta, që janë të përfshirë në edukimin parashkollor;
- Të hartojë politika afatgjata për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor, duke marrë parasysh numrin në rënie të fëmijëve të lindur brenda një viti në Kosovë.

## **5.2. Rekomandimet për Komunat**

- T'i japin mbështetjen e duhur nivelit të edukimit parashkollor/parafillor, me kompetencat që i ka Komuna me Ligjin e Arsimit për Komunat;
- Të zgjerohen objektet e institucioneve parashkollore aty ku ka mundësi dhe të ndërtohen të reja, sipas nevojës;
- Të kenë bashkëpunim me MASHT-in dhe ministritë e tjera për të ndihmuar së bashku në përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor;
- Të kenë bashkëpunim me Institutin Pedagogjik për të paraqitur pengesat dhe sfidat që ndikojnë në edukimin parashkollor në përgjithësi, në mënyrë që të kenë mbështetje institucionale për tejkalimin e sfidave;
- Të angazhojë bashkëpunëtorë profesionalë (pedagogë dhe psikologë) në institucione parashkollore.

## **5.3. Rekomandimet për institucionet parashkollore**

- Të kenë bashkëpunim me DKA-të, në mënyrë që të krijohen kushtet dhe mundësitë e përfshirjes më të madhe të fëmijëve në edukim parashkollor, me



rregullimin e ndonjë aneksi apo klase, apo edhe me ndërtimin e institucioneve të reja për edukimin parashkollor, që të përfshihej numër më i madh i fëmijëve në këtë nivel të edukimit;

- Të kenë bashkëpunim me MASHT-in dhe IPK-në, për mbështetje në realizimin cilësor të edukimit parashkollor;
- Të kërkojnë nga DKA-të bashkëpunëtorë profesionalë për institucionet e tyre.

#### **5.4. Rekomandimet për Institutin Pedagogjik**

- Të krijojë mundësitë që të përfshijë në hulumtim edhe institucionet private të licencuara;
- Brenda hulumtimeve të tjera, që do të realizohen në të ardhmen, të ketë specifika për etnitë e ndryshme të përfshira në edukimin parashkollor (si serbë, turq, boshnjakë, romë, ashkalinj, egjiptianë etj.).

#### **Falënderim**

Falënderohen të gjithë drejtorët/drejtoreshat e institucioneve parashkollore në Kosovë që ndihmuan realizimin e këtij hulumtimi dhe ofruan të dhënat nga institucionet e tyre.

## **7. Bibliografi**

Ligji mbi edukimin parashkollor Nr. 2/L-52, Kuvendi i Kosovës (2006).

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, 2011-2016 – MASHT.

Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme, 0-6 vjeç - MASHT 2011.

Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2012/2013, MASHT.

Udhëzimi administrativ 19/2009; Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm - MASHT, 2009.

<http://www.femijet.al/content.asp?idjadok=345>

## 8. Shtojca

---

Pyetësi i realizuar me drejtorë/drejtoresha të institucioneve parashkollore



### 9. PYETËSOR PËR DREJTORË/DREJTORESHA TË INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Instituti Pedagogjik i Kosovës do të realizojë projektin “Gjendja e përgjithshme në edukimin parashkollor publik në Kosovë”.

Të dhënat do të shfrytëzohen për qëllime statistikore dhe cilësore, lidhur me projektin.

Komuna \_\_\_\_\_

Institucioni parashkollor \_\_\_\_\_

Drejtori/eshja \_\_\_\_\_

---

#### Pjesa e parë e pyetësorit

1. Sa grupe me fëmijë të moshës 0 -3 vjet ka në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

2. Sa është numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjet? \_\_\_\_\_

3. A ka fëmijë me nevoja të veçanta në grup-moshat 0-3 vjet?

PO

JO

Nëse Po, sa fëmijë me nevoja të veçanta i keni në institucionin tuaj, moshë 0-3 vjet? \_\_\_\_\_

4. A ka motër-edukatore ndihmëse për këta fëmijë?

PO JO

4. Sa motër-edukatore i keni në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

6. Çfarë përgatitje profesionale kanë motër-edukatoret?

Sa me fakultet \_\_\_\_\_

Sa me shkollë e lartë \_\_\_\_\_

Sa me shkollë e mesme \_\_\_\_\_

7. A janë trajnuar motër-edukatoret për punën që e realizojnë?

Nëse po, cilat trajnime?

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

8. Sa motër-edukatore punojnë me një grup të fëmijëve? \_\_\_\_\_

### **Pjesa e dytë e pyetësorit**

9. Sa grupe të fëmijëve të moshës 3-4 vjeç ka në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

10. Sa grupe të fëmijëve të moshës 4-5 vjeç ka në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

11. Sa grupe të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç ka në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

12. Sa është numri i fëmijëve të moshës 3-4 vjeç në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

13. Sa është numri i fëmijëve të moshës 4-5 vjeç në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

14. Sa është numri i fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

15. A keni grupe të përziera në institucionin tuaj?

Nëse PO,

a) Sa grupe? \_\_\_\_\_ b) Sa fëmijë? \_\_\_\_\_

16. A ka fëmijë me nevoja të veçanta në grupmoshat 3 - 6 vjeç?

PO JO

Nëse Po, sa fëmijë me nevoja të veçanta keni në institucionin tuaj? \_\_\_\_\_

17. A ka edukatore ndihmëse që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta?

PO JO

Nëse PO, sa edukatore ndihmëse? \_\_\_\_\_

18. Sa është numri i edukatoreve që punojnë me fëmijët 3 – 6 vjeç? \_\_\_\_\_

19. Cila është përgatitja profesionale e edukatoreve, sa janë me?

a. Fakultet të Edukimit –Drejtimi Parashkollor \_\_\_\_\_

- b. Fakultet të Edukimit - Drejtimi Fillor \_\_\_\_\_
- c. Fakultet Filozofik - Drejtimi Pedagogji \_\_\_\_\_
- d. Shkollë të Lartë Pedagogjike \_\_\_\_\_
- e. Tjetër \_\_\_\_\_

20. A janë trajnuar edukatoret për punën që e realizojnë?

PO                      JO

Nëse Po, cilat trajnime?

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

21. A keni edukatore në institucion që nuk e kanë ndjekur asnjë trajnim?

PO                      JO

Nëse Po, sa është numri i tyre? \_\_\_\_\_

22. Me cilën metodologji e realizojnë punën edukatoret në institucionin tuaj?

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- d) \_\_\_\_\_

23. Sa edukatore punojnë me një grup të fëmijëve? \_\_\_\_\_

24. A ka në institucionin tuaj hapësirë për formimin e ndonjë klase (dhome) tjetër për fëmijë?

PO

JO

Nëse Po, arsyeto pse nuk formohen ato klasë?

---

---

---

---

---

25. Kërkesat e prindërve për regjistrimin e fëmijëve në institucion janë:

- a) të vogla
- b) të mëdha
- c) shumë të mëdha

26. Sa ka mundësi institucioni juaj t'i plotësojë kërkesat e prindërve?

a) pjesërisht

b) plotësisht

27. Sa është numri i fëmijëve që kanë aplikuar për pranim në institucionin tuaj, në vitin 2013? \_\_\_\_\_

28. Sa është numri i fëmijëve të pranuar në institucionin tuaj, në vitin 2013? \_\_\_\_\_

29. A ka pedagog në institucionin tuaj?

PO

JO

Nëse Jo, çfarë mendoni, a është e nevojshme të ketë pedagog institucioni parashkollor?

- a) Shumë
- b) pak
- c) aspak

30. Ndonjë koment lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet institucioni juaj?

---

---

---

---

---



**Botues**  
Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Shtypi**  
Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Tirazhi:500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

373.2(496.51)(047)

Aliu-Gashi, Mevlude

Gjendja e përgjithshme në edukim parashkollor  
0-6 vjeç, në institucionet parashkollore publike në  
Kosovë : raport hulumtimi / Mevlude Aliu-Gashi. -  
Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës. - 47 f.:  
ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Shkurtesat : f. 5. – Bibliografi : f. 40

**ISBN 978-9951-591-19-5**